



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**  
**AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL**

**NJOFTIM PËR SHTYP**

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural shpall thirrjen për aplikime nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019, me qëllim zhvillimin e sektorit bujqësor, blegtoral, zhvillimin e sektorit të ullirit dhe zonave rurale, bazuar në VKM nr.128 datë 13.3.2019 “Për Përcaktimin e Kritereve Bazë, të Sektorëve që do të Mbështeten dhe të Masës së Financimit nga Fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2019, të ndryshuar, dhe Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.3/1, Datë 15.04.2019

Thirrja do të qëndrojë e hapur nga data 23 Prill 2019 deri në datë 10 Maj për Masat Direkte me nr.1-6, dhe deri në datë 17 Maj për Masat e Investimeve me nr. 7-10.

Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për vitin 2019 ka në fokus mbështetjen e fermerëve të vegjël dhe blegtorëve në veçanti, rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve blegtorale, peshkimit dhe uljen e kostove të prodhimit, nëpërmjet pagesave direkte për të imta të matrikulluara, për dorëzimin e qumështit, për açuge dhe sardele të peshkuara. Bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr.3/1, datë 15.04.2019, fondi mbështetës për masat e përcaktuara është në vlerën prej 579 000 000 lekë, dhe 125 000 000 lekë nga projekti "Zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit të ullirit", dhe mbështet sektorët si më poshtë:

1. Mbështetje financiare për tufën bazë është 1.000 lekë për çdo krerë dele dhe/ose dhi
2. Dorëzimin e qumështit me 10 lekë/litër, për pagesat për dorëzimin e qumështit litër në pikat e përpunimit, për fermat që mbarështojnë lopë dhe/ose të imëta kundrejt fatures tatimore të shitjes, deri në shumën 700 000 lekë për subjekt.
3. Mbarështimin e bletarisë me 1 000 lekë për zgjua, për ferma me jo më pak se 50 zgjoje, por masa e financimit është jo më shumë se 150 000 lekë për subjekt.
4. Mbështetje ndaj anijeve të peshkimit me flamur shqiptar, në vlerën 20 lekë/kg per açuge dhe/ose sardele të peshkuara.
5. Mbjellje e ullinjve në vlerën 350 000 lekë/ha, për format intensive të kultivimit, dhe në vlerën 250 000 lekë/ha, për format tradicionale. Kur kultivari është autokton masa e financimit shtohet me 50 000 lekë/ha.

6. Përmirësimi i teknikave të ujitjes nëpërmjet instalimit të ujitjes me pika në ullinj, jo më shumë se 250 000 lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha.
7. Blerje e makinerive dhe pajisjeve për vjeljen e ullirit, me 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 lekë.
8. Blerje e makinerive dhe pajisjeve për prodhimin e vajit të ullirit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20 000 000 lekë për subjekt.
9. Mbështetje për ngritjen ose rikonstruksionin e ambienteve për veprimtari të turizmit rural nga 6 deri në 10 dhoma, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5 000 000 lekë për subjekt.
10. Mbështetje për investime në agroturizëm, kundrejt planit të biznesit, në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 10 000 000 lekë për subjekt. Përfitues janë subjektet, të cilët nuk mund të mbështeten nga Programi IPARD II.

Aplikimet do të kryhen online në 20 Agropika në Shqipëri, në 16 Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, ose nga vetë aplikanti nëpërmjet platformës E-Albania. Afati i fundit i dorëzimit të dokumentacionit, në Agropikën më të afërt, ose në zyrat qendrore të AZHBR, ose me postë në zyrat qendrore të AZHBR, është data 7.6.2019.